



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



02/Nr. 7763  
Data: 13.09.2023

**PROCESVERBAL I DËGJIMIT BUXHETOR ME HANDIKOS PËR DRAFT  
BUXHETIN PËR VITIN 2024 DHE PARASHIKIMET PËR VITET 2025-2026**

Procesverbali nga Dëgjimi i parë Buxhetor në lidhje me Draft Buxhetin e Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026, të mbajtur me datën **14.08.2023**, duke filluar nga ora **11:00** në **Sallën e Takimeve**, në objektin e Komunës së Hanit të Elezit që gjendet në katin e I-rë, me gjithsej 23 pjesëmarrës/e, prej tyre 9 gra dhe 14 burra. Nga ekzekutivi, të pranishëm ishin Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, **z.Mehmet Ballazhi**, si dhe drejtorët e drejtorive.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve nga Shoqata Handikos – Dega Hani i Elezit, që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin buxhetor për prezentimin e draft buxhetit të Komunës Hanit të Elezit për vitin 2024, si dhe parashikimi për vitet 2025-2026, ku për rend të punës, ishte:

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**
2. **Diskutimi**

**Mehmet Ballazhi thekson:** Jemi në fazën e dëgjimeve buxhetore publike për projektet që ne i kemi paraqitur, për t'i parë edhe ju se çka kemi në projeksionet buxhetore tona për këto vite dhe t'i marrim idetë dhe propozimet tuaja sipas kërkesave dhe nevojave tuaja që i keni, kështu që si edhe vitin e kaluar, po e mbajmë dëgjimin e parë buxhetor me Handikos, ne po mundohemi që me të gjitha kategoritë shoqërore të jemi në kontakt për të realizuar një plan buxhetor, i cili do të kalojë disa faza. Ne kemi bashkëpunu me të gjitha drejtoritë që kemi, kemi bërë disa propozime, kemi marrë parasysh edhe kërkesat e qytetarëve për projektpropozimet që ata na i kanë paraqit gjatë dëgjimeve të para në KAB, por gjithmonë duke iu dhënë prioritetin disa projekteve. Prezentimin e këtij draft buxheti do ta bëjë Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj.Lindita Ballazhi.

1. **Prezentimi i draft buxhetit të Komunës Hani i Elezit për vitin 2024 dhe parashikimi për vitet 2025-2026**

(Drejtoresha Lindita Ballazhi përshëndet dhe falënderon të pranishmit për pjesëmarrje në dëgjim buxhetor)

**Lindita Ballazhi thekson:** Buxheti paraqet një instrument mjaft të rëndësishëm financiar në të cilin specifikohen të hyrat dhe shpenzimet për një periudhë të caktuar kohore një vjeçare, duke

filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor. Planifikimi i Buxhetit Komunal kalon nëpër disa faza, duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Planifikimi buxhetor fillon me lëshimin e Qarkores së parë Buxhetore nga Ministria e Financave deri me 15 maj. Faza e dytë është hartimi i KAB-it në bazë të Qarkores Buxhetore ku kemi kufijtë fillestarë buxhetor. Për hartimin e KAB-it ne kemi mbajtur diskutime me asamblenë komunale, dëgjime buxhetore me qytetarët, si dhe është bërë miratimi i KAB-it në Kuvend Komunal më 30 qershor. Faza vijuese është pranimi i Qarkores së dytë Buxhetore nga ana e Ministrisë së Financave, e cila lëshohet më 15 gusht dhe më pas kemi bërë përgatitjen e draft buxhetit, si dhe vijon mbajtja e dëgjimeve publike. Faza përfundimtare e planifikimit buxhetor është miratimi i draft buxhetit në Kuvend Komunal, dhe veprimi i fundit është dorëzimi i draft buxhetit në Ministri të Financave deri më së voni 30 shtator. Buxheti i komunës përfshin këto struktura të financimit, ku për vitin 2024 do të jenë: granti i përgjithshëm (1,583,941.00 €), granti specifik për arsim (1,089,623.00€), granti specifik për shëndetësi (401,388.00€) dhe të hyrat vetanake komunale (274.736.00 €). Pra, buxheti total për vitin 2024 do të jetë 3,349,278.00 €. Në vazhdim, kemi bërë planin e ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale për vitin 2024, siç e shihni në projektor, këtu kemi të përfshime drejtoritë komunale, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, si dhe arsim dhe shkencë. Ndarja e buxhetit është bërë në bazë të kufijve buxhetor, për çdo kategori buxhetore: paga dhe shtesa, mallra dhe shërbime, shpenzime komunale, subvencione dhe transfere, si dhe shpenzime kapitale. Nëse e krahasojmë me vitin e kaluar, kemi një rritje të dukshme në të gjitha kategoritë buxhetore, përveç tek të hyrat vetanake komunale ku do të ketë rënie prej 51%. Mandej vijojnë të gjitha projektet kapitale të cilat i keni para vetes tuaj në letër, të cilat janë planifikuar nga drejtoritë dhe ekzekutivi, si dhe disa janë marrë edhe nga dëgjimet paraprake që kemi pasur në qershor. Nëse keni ju ndonjë projekt propozim apo kërkesë, mundeni ta parashtroni.

## 2. Diskutimi

**Mehmet Ballazhi:** Pas prezantimit nga drejtoresha, unë e hap diskutimin për të pranishmit.

**Nerxhivane Berisha:** Për qasjen nëpër qytet, për pjerrinat për me u kyq në trotuare personat me karrocë, konkretisht te udhëkryqi te komuna. Poashtu te veranda me ofru qasje edhe për personat me karrocë, në rast se ka reshje shiu. Znj.Lindita Kaloshi ka ofru gatishmërinë që vullnetarisht me dhanë si një lloj kursi për personat me aftësi të kufizuara spaku për me iu mësu shkrim dhe lexim, dhe ne kërkojmë me na u mundësu një hapësirë te Shtëpia e Kulturës për me zhvillu si aktivitet për një kohë të caktume. Poashtu një anëtar i shoqatës, Qani Bushi protezën e ka shumë të dëmtume, a kishte qenë e mundur që ju si komunë me e dërgu një kërkesë në Ministrinë e Shëndetësisë që me ja mundësu një protezë të re?

**Mehmet Ballazhi:** Në lidhje me pjerrinat, i marrim ma konkretisht se ku ka nevojë për ndërhyrje. Gjithashtu edhe tek veranda te parku, jemi tu e pa mundësinë që gjatë këtij viti me e realizu që me u bo një vend aty. Kurse për me e lëshu hapësirën për zn.Lindita me dhanë mësim të shkrim leximit, na e bëni një kërkesë me shkrim. Sa i përket protezës, edhe invalidët e luftës që janë me proteza të cilët edhe pse kanë bo kërkesa përmes shoqatës së invalidëve por nuk iu kanë realizu. Ne mundemi me dërgu naj aplikacion, formular, ose me i përcjell kërkesat.

**Zyrafete Ramuka:** Për personat me aftësi të kufizuara me i ofru së paku barnat esenciale që me mujt ju si komunë me i sjell , shkak se janë të kushtueshme edhe gjenden vështirë, një listë e kemi dorëzu te drejtoresha.

**Mehmet Ballazhi:** Ne si komunë mundësitë i kemi të kufizume, kemi diskutu me Agon Zhinipotoku, një bamirës nga Jetimat e Ballkanit, i cili ka thanë që me ua përcjell një listë me barna që janë të kushtueshme, por që nuk do të jetë e përhershme ajo, mundet me u bo furnizimi për një kohë të caktume, por që të jenë barna që nuk gjenden lehtë. Ndërsa listën e barnave esenciale e përcakton Ministria e Shëndetësisë, por nga komuna e kemi të kufizume, shembull ne cka kemi mujt me bo vitin e kalum ka qenë rehabilitimi në banjë t'kllokotit.

**Naser Laçi:** Kisha propozu që subvencionet me u rrit pak ma shumë për shoqatën Handikos për me i realizu aktivitetet.

**Nerxhivane Berisha:** Kemi dashtë me i vazhdu mbledhjet e Komitetit për persona me aftësi të kufizuara, por nuk janë thirr mo mbledhjet, pse?

**Natyra Kalisi:** Në lidhje me Komitetin, kemi kërku sqarim prej Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe përgjigja ka qenë se për shkak të Ligjit të ri të pagave , të gjitha rregulloret për kompenzimet janë shfuqizu, pra asnjë lloj i Komitetit nuk paguhen përpos atyre obligative, pra në këtë aspekt nuk kemi faj ne si komunë, kemi kërku edhe zgjidhje tjera për me arrit me i kompensu të gjitha komitetet, por nuk kemi mujt me gjet asnjë mënyrë.

**Hamim Kaloshi:** Sa ka mundësi që me na mundësu së paku transportin për në qendra rehabilitimit nëse shkojmë individualisht, por edhe me e subvencionu shoqatën me i dërgu ata që kanë nevojë? Poashtu, nëse do të ishte e mundur me u vendos një semafor për persona me nevoja të kufizume te udhëkryqi te marketi Besa ose me e kërku ju nga Ministria vendosjen e këtij semafori, shkak se unë personalisht jam rreziku.

**Mehmet Ballazhi:** Vitin e kaluar kemi subvencionu 10 persona nga Handikos për rehabilitim në Banjë, gjithashtu edhe këtë vit por edhe vitet e ardhshme, do të subvencionohet me rehabilitim, por varet nga shoqata juaj se kë e përcakton me më shumë nevojë për me i dërgu në rehabilitim, ku përfshihet edhe transporti. Gjithashtu edhe për personat nga shoqata juaj që shkojnë me mjete të tyre për rehabilitim, mundemi me e siguru transportin. Kërkesa siç e thash edhe ma herët nuk është problem me i dërgu.

**Avni Bajramaliu:** A ka mundësi punësimi për persona me aftësi të kufizuar?

**Mehmet Ballazhi:** Çështjen e punësimit e marrim si rekomandim dhe do t'i shohim mundësitë që i kemi.

**Nerxhivane Berisha:** Në lidhje me tatimin në pronë, sipas një ligji për personat me aftësi të kufizuar, gjithashtu edhe te e-Kosova shkrun që personat paraplegjik janë të lirum nga pagesa e tatimit në pronë. Gjithashtu tash që do të bëhet me pagese uji i pijshëm, a do të ishte e mundur ulja e pagesës?

**Lindita Ballazhi:** Janë disa ligje që bijnë ndesh me njëra tjetrën, por Ligji i tatimit në pronë parasheh vetëm institucionet shtetërore, kurse për të tjerët është obligim pagimi i tatimit të pronë.

**Mehmet Ballazhi:** Kompania rajonale Bifurkacioni e monitoron pjesën e furnizimit me ujë, për momentin jemi hala në fazën testuese, ku përfshihen analizat, çështjet e pagesave, identifikimi i pikave ku keqpërdoret apo monitorime tjera dhe ato vendosen më vonë.

**Hamim Kaloshi:** Diçka që vërehet në Han të Elezit është mungesa e ndërgjegjjes, ku po prishen koshat e mbeturinave, dritat për ndriçim publik, apo edhe karriget, tu e përfshi edhe parkun.

**Lindita Ballazhi:** Ne i kemi shënuar të gjitha kërkesat e juaja, rekomandimet dhe diskutimet tuaja dhe të gjitha do të shqyrtohen dhe do të japim maksimumin që së paku disa të ua realizojmë. Çfarëdo kërkesë që keni, jo vetëm nëpër dëgjime, por çdo herë dyert tona janë të hapura në çdo kohë.

**Mehmet Ballazhi:** A ka edhe dikush diçka me shtu apo me plotësu? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur dëgjimin buxhetor të dedikuar për Handikos.

Mbledhja përfundoi në ora 12:05.

**Procesmbajtësja**  
**Liridona Ballazhi**




**Kryetari i Komunës**  
**Mehmet Ballazhi**



Lista e pjesëmarrësve  
Drejtoria për Buxhet dhe Financa  
Dëgjimi Buxhetor – “Handikos”

Data: 14.08.2023

Nr.	Emri Mbiemri	Nr.	Email	Nënshkrimi
1	AVNI BARDHALIU			A.B
2	Havushe loki			H.L
3	Amie Jushi			
4	ALSIM DERJANI			
5	Mimete Haka Haxhelari			
6	MARJONA KANGANI			
7	Dantun Koloshaj			
8	Rezart Mehmed		Rezart.mehmed@handikos.com	
9	Natya Kalisi		natya.kalisi@iks-govt.com	
10	Nexhmishi, Davi		nexhmishi-davi@igs.govt.com	
11	Arsmi Gaur		arsmi.gaur@vlls.govt.com	
12	Naser Kagi		naseri-20@handikos.com	

13	Kuytini Dejazani	[REDACTED]	Kuytini Dejazani @kuis-gov.net	[REDACTED]
14	RRAMAN BUSHI	[REDACTED]	Bushirahmanov.gno@gmail.com	[REDACTED]
15	Moshirano Borishta	[REDACTED]	N.B	[REDACTED]
16	Edijj Borisha	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
17	Erdete-Ramuka	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
18	Hamim Xelezi	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
19	Ali <del>XXXX</del>	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]
20	AMIR DERNIANI	[REDACTED]	[REDACTED]	[REDACTED]

21. LIRIDONA BALLAZHI  
[REDACTED]
22. LINDITA BALLAZHI  
[REDACTED]
23. MEHMET BALLAZHI  
[REDACTED]